

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Hyrje

Sot ne daten 19/12/2019, u mbledh asambleja e ortakeve te shoqerise "Vellezerit Murtaj 2020" SH.P.K per krijimin e shoqerise ne baze te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ne kete statut :

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", I ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;
- "Ditë të Plota" në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Shoqëria themelohet në datën 19.12.2019.
- (2) Emri i shoqërisë është "Vellezerit Murtaj 2020" SH.P.K.
- (3) Themelues I shoqërisë është;
- Kostaq Murtaj, i datelindjes 05.06.1994, lindur dhe banues ne Sarande.

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Tregeti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem ushqimor, industrial, produkte buqesore e blegtorale, veshmbathje, artikuj elektroshtepiak etj, si dhe import-eksportin e tyre.
- Sherbime hoteleri, bar-restorant, akomodime ne plazhe etj.
- Sherbime te ndryshme transporti dhe turistike.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afate.

Neni 4: Selia, dhe Adresa Elektronike

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:
Godina nr.168, rruga "Abedin Dino", lagja nr.3, Sarande..
- (2) Adresa elektronike: e-mail: mkostaq@gmail.com.
- (3) Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit:
Godina nr.15, Rruga "Ismail Qemali", Lagja nr.4, Sarande.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- (1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë, ose 1 pjese ne shumen 100.000 leke.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me Kontributin e tij:

1. Ortaku themelues : **Kostaq Murtaj**

Kontribut në para në shumën 100.000 leke, I cili zoteron 100 % të pjeseve të kapitalit të shoqërisë.

2. Kontributet në para do të tranferohen menjehere nga ortaku në aktivet e shoqërisë.

Neni 6: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Ortaket kanë të drejten e parablerjes së kuotave të kapitalit, në rast të shitjes nga ndonjë ortak i shoqërisë.

Neni 7: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 8: Blerja e Kuotave të Veta

(1) Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'i shpërndahet ortakut apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritet tregtare".

Kreu III Asambleja e Përgjithshme

Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Administratori thërret Asamblesën e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakut sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thërret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar ortakut. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e të dërgohet ortakut, jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

(3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku është dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaku ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortaku që merr pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (2) Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (3) Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortaku i vetëm dhe me të drejtë vote drejton mbledhjen.
- (4) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- (5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- (6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë.

Neni 11: Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjitheshme

Asambleja e pergjitheshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te shoqerise per ceshtjet e meposhteme :

- (1) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- (2) Ndryshimin e statutit
- (3) Emerimin e shkarkimin e administratorit
- (4) Emerimin e shkarkimin e likujduesve, eksperteve kontabel si dhe shperblim e tyre, etj.
- (5) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore.
- (6) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- (7) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- (8) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji.

Neni 12: Votat e Ortakut

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

Neni 13: Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu IV Administratorët

Neni 14: Emërimi i Administratorëve

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm emërohet Administratorë i shoqërisë për një afat 5 vjet.
- Kostaq Murtaç i cili është dhe ortak i shoqërisë.

Neni 15: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërras Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16: Perfaqesimi

- (1) Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
- (2) Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- (3) Administratori nuk mund të delegoje detyrimet e tij ligjore.

Neni 17: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi në ushtrimin e detyres.

Neni 18: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

- (1) Administratori shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.
- (3) Administratorit mund t'i paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me me përmbushjen e detyrave të tij.

Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 19: Dividendët

- (1) Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakut.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 20: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 21: Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 22: Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

(3) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti.

Emri dhe nënshkrimi ortakut themelues:

Kostaq Murtaq

